

Kronoberg Vårdval – aty ku qytetarët zgjedhin qendrën e tyre rajonale të shërbimit shëndetësor

Vårdval Kronoberg do të thotë që qytetarët e bashkisë së Kronoberg-ut kanë mundësi të përzgjedhin lirisht për vete qendrën rajonale të shërbimit shëndetësor. Mund të zgjidhni atë qendër kujdesi shëndetësor e cila i përshtatet më mirë nevojave dhe kërkesave tuaja personale. Të gjithë qytetarëve iu caktohet ajo qendër rajonale shëndetësore që kanë përzgjedhur vetë dhe, nga ana tjetër, qendrat duhet t'i përshtasin veprimtaritë e tyre në bazë të numrit të qytetarëve të cilët kanë zgjedhur çdo qendër të veçantë shëndetësore. Mund të gjeni një listë të plotë të të gjitha qendrave rajonale të shërbimit shëndetësor në internet në faqen kryesore të bashkisë, në adresën: www.ltkronoberg.se/vardval.

Si kryhet zgjedhja?

Mund të zgjidhni në çfarëdo kohe një qendër rajonale të shërbimit shëndetësor dhe nëse nuk jeni i kënaqur nga kjo zgjedhje, jeni i lirë të zgjidhni një qendër tjetër. Zgjedhja bëhet me shkrim duke përdorur një formular aplikimi i cili mund të shkarkohet nga faqja kryesore e bashkisë në internet, në adresën www.ltkronoberg.se/vardval, ose mund të tërhiqet personalisht në secilën prej qendrave rajonale shëndetësore të bashkisë ose, ndryshe, mund të porositet nëpërmjet shërbimit të qendrave rajonale shëndetësore (me numër telefoni 0470 58 96 60). Nëse jeni plotësisht i kënaqur nga vendosja gjeografike e qendrës suaj rajonale të shërbimit shëndetësor, nuk është nevoja të dërgoni formularin e mësipërm të aplikimit.

Katër çështje thelbësore

Përzgjedhja e qendrës rajonale të shërbimit shëndetësor në qarkun e Kronoberg-ut bazohet në katër pika thelbësore.

- Liri zgjedhjeje – Qytetarëve të bashkisë iu jepet mundësia të zgjedhin një qendër rajonale shërbimi shëndetësor e cila përputhet me kërkesat parësore individuale përsa i përket shërbimit shëndetësor ambulatorial si dhe shërbimeve mjekësore. Qendrat rajonale shëndetësore duhet t'i mirëpresin të gjithë pacientët dhe t'i përshtasin burimet e shërbimit e tyre në përputhje me ta.
- Disponueshmëri – Do të jetë më e lehtë të kontaktohen shërbimet shëndetësore. Qëllimi është që të përftohet një nivel përdorimi e disponueshmërie më i mirë sesa niveli minimal i nënshkruar në garancinë e siguracionit shëndetësor. Gjithashtu, kjo nënkupton që do të jetë më e lehtë të prenotohen vizitat ose, tjetër, që qendrat rajonale të shërbimit shëndetësor do të përmirësojnë oraret e hapjes për publikun në krahasim me gjendjen e tanishme.
- Shumëllojshmëri – Një prej pikësnyimeve është që qytetarët të mund të kenë në dispozicion një numër më të madh ofruesish të shërbimit shëndetësor prej të cilëve të kenë mundësi të zgjedhin.
- Kosto/efikasitet – Sistemi do të planifikohet në mënyrë që të rritet raporti kosto/efikasitet.

Qendrat e miratuara rajonale të shërbimit shëndetësor

Qendrat rajonale të shërbimit shëndetësor që bëjnë pjesë në *Vårdval Kronoberg* duhet të pajisen me miratimin e këshillit të qarkut të Kronoberg-ut. Për të përfutur këtë miratim ato duhet të përmbushin kërkesat kryesore të përcaktuara nga këshilli i qarkut ku përfshihen shërbimet bazë të

kujdesit shëndetësor dhe të trajtimit mjekësor, shërbimet këshilluese, masat parandaluese, shërbimet e rehabilitimit, shërbimet shëndetësore për fëmijët si dhe profesionalitetin psikiatrik. Qendrat rajonale të shërbimit shëndetësor duhet gjithashtu të jenë plotësisht në përputhje me ligjin dhe legjislacionin mbi shërbimin shëndetësor dhe trajtimin mjekësor, të mbajnë të larta nivelet e aftësive profesionale si dhe të sigurojnë një shërbim shëndetësor cilësor. Qendrat rajonale të shërbimit shëndetësor mund të dallohen lehtë me anë të simboleve *Vårdval Kronoberg*.

Kompetencat dhe profesionaliteti

I gjithë stafi sanitar dhe mjekësor dhe të punësuarit e tjerë duhet të kenë kompetencat, regjistrimet dhe autorizimet e detyrueshme nga shteti. 75% apo më tepër e specialistëve në gjithë qendrat rajonale shëndetësore duhet të jenë mjekë të përgjithshëm dhe të paktën 50% e infermierëve duhet të jenë infermierë rajonale të trajnuar.

Fondet për shërbimet mjekësore dhe kujdesin shëndetësor

Në kuadrin e procesit të përzgjedhjes së shërbimit shëndetësor, të gjitha qendrat rajonale të kujdesit shëndetësor përftojnë kompensim financiar nga këshilli i qarkut në bazë të numrit të pacientëve që kanë zgjedhur çdo qendër të veçantë. Ky kompensim, i njohur edhe si fondi për shërbimet mjekësore dhe kujdesin shëndetësor, ndryshon në bazë të moshës së qytetarëve. Pacientët do të paguajnë tarifa të njëllojta në të gjitha qendrat rajonale shëndetësore të përfshira në procesin e përzgjedhjes së qendrave në *Kronoberg Vårdval*. Të njëjtat rregulla vlejnë për kartat shëndetësore të pagesave maksimale dhe për kartat shëndetësore pa pagesë.

Mbikqyrja e mëtejshme

Këshilli i qarkut do të monitorojë të gjitha aktivitetet për t'u siguruar që të gjitha qendrat e kujdesit shëndetësor veprojnë në pajtim me linjat drejtuese dhe kushtet e përcaktuara. Në rast se një qendër rajonale shëndetësore dështon në përmbushjen e këtyre kushteve, këshilli i qarkut mund të reduktojë fondet për shërbimet mjekësore dhe shëndetësore.



Simbol që tregon një qendër të miratuar rajonale të shërbimit shëndetësor në bashkinë e Kronoberg-ut.